



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:000685
Datë: 28.02.2022
Numri i dokumentit: 02761940
P.nr.1/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gëzim Ademi, me praktikanten e rregullt të kësaj gjykate, Egzona Sejdiu, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: A.M nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nënpar. 3.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1948/2021 të datës 05.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 11.02.2022, në mungesë të të pandehurit dhe të prokurores së shtetit, N.T, e shpalli publikisht, në të njëjtën ditë, ndërsa me datë 28.02.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.M me nofkën "...", nga babai B dhe nena E, e vajzërisë H, i lindur me ..., në Mitrovicë, ku edhe jeton në rrugën "...", ka të përfunduar shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion punëtor teknik në Spitalin e Mitrovicës, me numër personal ..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Kosoves

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse,

Me datën 31.10.2021, rreth orës 18:00, në Mitrovicë edhe pse ka qenë në gjendje që të kuptoj rëndësinë e veprës së vet dhe të udhëheq me veprimet e veta, dhe i vetëdijshëm për veprën e vet ka dashur kryerjen e së njëjtës, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore bashkëshortes së tij – të dëmtuarës E.S, në atë mënyrë që së pari ka shkuar në vendin K, ku ka qenë bashkëshortja e tij (në shtëpinë e prindërve të saj) e ka thirrur të njëjtën që të shëtisin, pastaj më automjet kanë shkuar afër lumit Ibër, ka filluar me ofendime verbale të të dëmtuarës me pretendimin se po e

mashtro, pastaj fizikisht i është vërsulur, duke e goditur me duar në fytyrë dhe trup dhe duke ia shkullur – tërhequr të njëjtës flokët, ku me atë rast e dëmtuara ka pësuar lëndime në formë të gërvishtjeve në regjionin e dorës së djathtë, hematome në regjionin e kërcirit të këmbës së majtë dhe në regjionin e shpinës – lëndime të karakterizuara si lëndime të natyrës së lehtë,

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nënpar. 3.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69, lidhur me nenin 185 par.3 nënpar. 3.1 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohëzgjatje prej një (1) viti.
2. Obligohet i pandehuri, që të i paguajë shpenzimet e procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëzet (20) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur PP.II.nr.1948/2021 të datës 05.01.2022, kundër të akuzuarit: A.M nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nënpar. 3.1 në lidhje me par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK. Prokuroria e Shtetit së seancën e shqyrtimit fillestar të dt 11.02.2022, ka bërë kualifikimin e veprës penale, ashtu që duhet të hiqet “lidhur me par. 1 nen par 1.4”, kjo pjese duhet të hiqet nga kualifikimi juridik i veprës penale.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datën 11.02.2022, në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë, që i vie keq për rastin që ka ndodhur, deklaroi se ka raporte shume të mira me bashkëshorten e tij, i kanë dy fëmijë dhe i propozon gjykatës që të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, duke u mbështetur edhe në provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës, e me rastin e shqyrtimit të dënimit, pranimin e fajësisë nga i pandehuri ta merr si rrethane lehtësuese. Gjithashtu, Prokuroria propozon që si rrethanë lehtësuese të merret edhe fakti se i pandehuri është pajtuar me të dëmtuarën dhe të njëjtët kanë edhe një fëmijë çka dëshmon që raportet martesore janë përmirësuar dhe kanë raporte të mira bashkëshortore.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-BC-1029 i datës 31.10.2021; raporti i policit i datës 01.11.2021; raport i shpejtë i datës 31.10.2021; raporti ditor i dhunës familjare i datës 31.1.2021; deklarata e të dëmtuarës e datës 01.11.2021; deklarata e të pandehurit e datës 01.11.2021; raporti mjekësor mbi lëndimet e pësura të datës 01.11.2021 dhe raporti i ekspertit të mjekësisë ligjore të datës 09.12.2021; fotodokumentacioni me gjithsej tetë (8) foto si dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – divizioni civil C.nr.1646/2021 të datës 16.11.2021. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë penale është parapare dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprat penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, moshën e tij të re, gjendjen ekonomike dhe familjare të tij si dhe faktin se i pandehuri me të dëmtuarën është pajtuar dhe kanë raporte të mira bashkëshortore.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se dënimi me burgim është në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga veprimet e ndaluara në komunikacion.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Kështu, në emër të paushallit gjyqësor është obliguar të paguaj shumën prej 20 euro, taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30€, është bazuar në nenin 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv, në kuptim të nenit 463 të KPP-së, duke qenë se të dhënat e ofruar në procedurë nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin edhe të kërkesës pasurore juridike. Andaj, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje të lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 1/2022, dt.28.02.2022

G j y q t a r i:

Gëzim ADEMI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.